



Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve

Kosovo Institute for the Protection of Monuments/ Institut Kosova za Zaštitu Spomenika

Revista „Dardania” - Trashëgimi Kulturore

Revista „Dardania” - Trashëgimi Kulturore i dedikohet të gjithë studiuesve e punonjësve shkencorë të shkencave të ndryshme sociale. Revista ka për qëllim thellimin e studimeve në fushën e trashëgimisë Kulturore, nga studiues të brendshëm e të jashtëm, që do të shfaq arritjet e derisotme të studiuesve që kanë trajtuar problematika të karaktereve të ndryshme të kësaj fushe.

THIRRJE E HAPUR PËR PUNIME

Nga data 29.07.2022 deri më 29.09.2022

Në emër të Redaksisë së Revistës ftoheni të aplikoni me punime në Revistën **“Dardania” Trashëgimi Kulturore**, duke dërguar punimet deri me datë 29 Gusht 2022.

Temat e propozuara:

Temat e mëposhtme propozohen (por nuk kufizohen) të jenë nga fusha e trashëgimisë kulturore: histori, histori e artit, arkitekturë, arkeologji dhe etnologji, trashëgimi jo materiale shpirtërore, etj.

Punimet dorëzohen me postë elektronike, në versionin Microsoft word, pasi të jenë lekturuara dhe korrektuara. Tekstet e pa lekturuara dhe të pa korrektuara nuk do të botohen dhe si të tilla refuzohen. *(dërgimi i versioneve në PDF dhe forma tjera të pa editueshme nuk pranohet).*

- Rekomandimet e mëposhtme kanë të bëjnë me çështje teknike të punimit për botim në revistën **„Dardania” - Trashëgimi Kulturore**

Kriteret për dorëzim të punimit në Revistën „Dardania” - Trashëgimi Kulturore

- Punimi duhet të përmbajë 5 deri në 10 faqe në word, apo nga 2625 fjalë deri në 5250 fjalë (përfshirë fotografitë)
- Fotografitë duhet të përfshihen brenda dokumentit word, por të njëjtat duhet të bashkëngjiten edhe si JPG, PNG, BMP, etj.

Secili punim që dërgohet në adresën e revistës duhet të përmbajë edhe:

- Titullin e punimit, emrin e autorit dhe institucionin ku punon dhe adresën elektronike;
- Përmbledhjen e shkurtër ose abstraktin (200-250 fjalë);
- Fjalët kyçe;
- Tekstin e punimit me fusnota të sakta, i cili mund të jetë i shoqëruar me fotografi, skica, grafikone, tabela, etj., të kualitetit të lartë.

- Bibliografinë.

Dorëzimi i punimit

- Autori duhet të dorëzoj punimin në formë elektronike në adresën revista.dardania@rks-gov.net;
- Për vërejtjet, sugjerimet, pranimin apo refuzimin e punimit të dërguar, autorët do të njoftohen nga redaksia brenda 20 ditësh pas mbylljes së afatit për dërgim të punimeve;
- Në rast të kërkimit të plotësimeve shtesë nga redaktorët përgjegjës, autorët kanë një afat shtesë prej 7 ditëve për t'i plotësuar ato.

Revista „Dardania” - Trashëgimi Kulturorë

- Artikuj të publikuar me parë në ndonjë revistë, kapitull apo pjesë të ndonjë libri, faqe interneti etj; nuk pranohen.
- Artikuj të karakterit të përgjithshëm informative në të cilët autorët nuk paraqesin origjinalitet dhe të dhëna të reja apo interpretim të ri, nuk pranohen.

➤ **Luten që autorët e teksteve t'i respektojnë plotësisht kërkesat për botim.**

Autorët, artikujt e të cilëve do të publikohen në Revista „Dardania” - Trashëgimi Kulturorë do të përfitojnë:

- Publikim efikas dhe të shpejtë;
- Një kopje të revistës në formë elektronike dhe fizike.
- Shpërndarje të gjerë.
- Promovim të çdo artikulli të botuar.
- Pagese për punim 100 Euro.

Adresa:

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve

Rr. Zenel Salihu, #9 Prishtinë, 10000

Tel: +383 (0) 38 200 227 07

E-mail: revista.dardania@rks-gov.net